



Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 22 të Ligjit NR.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 58 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6.2 shkronja a) dhe h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, më date 23.11.2022, merr këtë:

Data 29.11.22		Vendi KASANI
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	10562-31608	

VENDIM

PER FORMIMIN E KOMISIONIT PËR MBIQYRJEN E REALIZMIT TË KONTRATAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SIPAS PLANIT DINAMIK REALIZUES

I. Formohet Komisioni për mbikqyrjen e realizmit të Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas planit dinamik realizues, në këtë përbërje:

1. Besmir Krasniqi- DBF
2. Festim Neziraj- Zyra e Personelit
3. Agron Dema-DZHET
4. Edmond Mjaku- DUKMM dhe
5. Jeton Topalli-DSHMS

II. Komisioni ka për detyrë që në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të analizojë të gjitha kontratat e lidhura deri më 31.12.2021, të dalë në vendet e ngjarjes, pra ku është dhënë prona komunale në shfrytëzim dhe të hartojë nga një raport për secilën pronë, dhe të vërtetojë se a është respektuar plani dinamik realizues sipas kontratës dhe të njoftohet zyra e Kryetarit.

III. Për sigurimin e Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe materialeve tjera, do të kujdeset DUKMM.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

V. Me këtë Vendim të njoftohen:

Zyra e Kryetarit,
Anëtarët e Komisionit dhe
Arkivi i Komunës.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



I	Data	29.11.22	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/02-21605-1			

Datë: 23.11.2022

Ne mbeshtetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.1 e datës 12.01.2012, Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014, Ligjit Nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunes së Kaçanikut, merr:

VENDIM

PER FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

I. Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, në këtë përbërje:

- 1.Zekir Selimi - DUKMM
- 2.Mentor Shehu - DUKMM dhe
- 3.Labinot Selmani - DZHET

II. Komisioni, për zbatimin e dispozitave të Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.1 e datës 12.01.2012 dhe dispozitave të Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr. 04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022, autorizohet si vijon :

1. Kompletion shenimet e kërkuara me Ligjin e cekur për banesat në pronësi të Komunës, të cilat ende nuk janë blerë nga bartësit e të drejtës banesore.
- 2.Njofton bartësit e së drejtës banesore, përkatësisht shfrytëzuesit e banesës për të drejtën për blerjen e banesës dhe dokumentacionin i cili duhet t'i bashkëngjitet kërkesës në pajtim me Ligjin.
3. Shqyrton kërkesat e bartësve të së drejtës banesore për banesat të cilat dhënësi i banesave është Komuna si dhe për banesat për të cilat do të vërtetohet paraprakisht se nuk iu dihet kush do të jetë shitësi konform dispozitave të nenit 10 të Ligjit bazik.

4. Ne pajtim me Ligjin, me dëshmi perkatëse vërtetohet se a është shtetë parashtruesi i kërkesës ne grupin e personave që e kanë te drejtën për blerjen e banesës.

5. Ky Vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

6. Me këtë Vendim te njoftohen:

Kryetari i Komunës,
Anëtarët e Komisionit,
Drejtoria e Financave dhe
Arkivi i Komunës.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

